

VENDIM
Nr. 184, datë 4.4.2019

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 128, DATË 13.3.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN E TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 128, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Pas shkronjës “b, të pikës 1, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:
“c) Në fondin e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (Ilogaria ekonomike 606), i miratuar në buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shtohet shuma prej 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekësh për pagesat për dorëzimin e qumështit, lëndë e parë nga fermerët.”.
 - b) Shkronja “b, e pikës 2”, ndryshohet si më poshtë vijon:
“b) Dorëzim qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat që mbarështojnë lopë dhe/ose të imëta, kundrejt faturës tatimore të shitjes, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për subjekt.”.
2. Fondi prej 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekësh përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht:
 - a) 32 000 000 (tridhjetë e dy milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 01130 “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”;
 - b) 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 04160 “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastruktura e cilësisë dhe pronësisë industriale”;
 - c) 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”;
 - ç) 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 10220 “Sigurimi shoqëror”.
3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama